




BASHKIA PATOS



**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË
MBETJEVE TË NGURTA URBANE**

BASHKIA PATOS

2025-2030

Tabela e Përmbajtjes

I.	HYRJE	3
1.1	Nevoja për hartimin e PLMIMNU	3
II.	POLITIKAT KOMBËTARE DHE RREGULLIMI LIGJOR E INSTITUCIONAL NË MENAXHIMIN E MBETJEVE	5
2.1	Politika kombëtare dhe parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve	5
2.2	Aspektet institucionale të menaxhimit të mbetjeve	7
2.2.1	Organizimi në nivel qendror	7
2.2.2	Organizimi në nivel lokal	7
2.3	Instrumentet e menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor	8
III.	PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME	10
3.1	Të dhënat gjeografike dhe demografike	10
3.2	Organizimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.	11
3.3	Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve	12
3.4	Gjenerimi i mbetjeve dhe trajtimi final i mbetjeve	12
3.5	Aspektet financiare të shërbimit të pastrimit	12
3.5.1	Niveli i tarifës për familjet	13
3.5.2	Niveli i tarifës për biznesin	14
IV.	INDIKATORËT E PERFORMANCËS	17
V.	PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE	20
5.1	Vizioni	20
5.2	Objektivat	21
5.2.1	Rrymat e mbetjeve në bashkinë Patos	21
5.2.2	Zona e Administrimit të Mbetjeve dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit	22
5.3	Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve	23
5.3.1	Shërbimi i pastrimit dhe rrugëve	23
5.3.2	Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve	24
5.3.3	Minimizimi i mbetjeve	24
VI.	SKEMAT E PROPOZUARA PËR GRUMBULLIMIN E MBETJEVE	25
VII.	RREGULLORE BASHKIAKE PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE	28
7.1	Rregullorja dhe plani i monitorimit	28
7.1.1	Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve	29
7.1.2	Të drejtat dhe detyrimet e grumbulluesve të mbetjeve	29
7.1.3	Plani i veprimit	33
7.1.4	Plani i monitorimit	35
7.1.5	Zbatimi i rregullores	37

I. HYRJE

1.1 Nevoja për hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane.

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për Bashkinë Patos është një dokument strategjik i domosdoshëm që mundëson zbatimin në nivel lokal të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve, duke shërbyer si udhëzues praktik për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë.

Ky plan ofron një orientim të qartë strategjik për të ardhmen dhe synon të krijojë një qëndrim të përbashkët ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë për të përmirësuar performancën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

PLMIMNU përqendrohet në veprime konkrete dhe të detajuara që lidhen me:

- Grumbullimin,
- Trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve,
- Trajtimin final dhe menaxhimin e impianteve të dedikuara për mbetjet.

Qëllimi i këtij plani është të përballojë sfidat e reja që ka Bashkia Patos për të siguruar ofrimin e shërbimeve të pastra, efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e saj, duke harmonizuar interesat e komunitetit dhe institucioneve publike, duke optimizuar koston e shërbimeve në përputhje me buxhetet e kufizuara vendore.

Plani parashikon vlerësimin e alternativave më të mira të menaxhimit të mbetjeve, përcaktimin e nevojave për investime kapitale, si dhe vendosjen e një metodologjie të qartë për zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

Më konkretisht, PLMIMNU për Bashkinë Patos synon:

- Sigurimin e përputhshmërisë me Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, duke kontribuar në arritjen e objektivave kombëtare;
- Identifikimin e opsioneve optimale të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane në përputhje me hierarkinë e mbetjeve (parandalim, riciklim, kompostim, trajtim dhe depozitimi përfundimtar);
- Përcaktimin dhe përmirësimin e kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator në nivel lokal, për një menaxhim më efektiv dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Hartimin e një programi të qartë për investime dhe sigurimin e burimeve financiare, si nga buxheti vendor, ashtu edhe nga fondet qeveritare dhe burime të tjera ndërkombëtare;
- Ngritjen e kapaciteteve teknike dhe administrative në Bashkinë Patos për implementimin dhe ndjekjen e Planit.

Në këtë proces, edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit përbëjnë një element kyç për suksesin e planit. Ndërgjegjësimi qytetar mbi rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim, reduktimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin do të jetë thelbësor për ndërtimin e një kulture të re të menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në Bashkinë Patos. Plani parashikon zhvillimin e

fushatave të edukimit dhe informimit për të gjitha grupmoshat dhe nivelet e shoqërisë, duke përfshirë veçanërisht institucionet arsimore, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile.

Menaxhimi i mbetjeve i është deleguar njësite të vetëqeverisjes vendore që nga viti 1994, duke i bërë ato përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e këtij shërbimi jetik.

Hartimi i PLMIMNU është një detyrim ligjor i përcaktuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i ndryshuar, ku neni 12, pika 2, përcakton se:

“Çdo njësi e qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me Planin Kombëtar dhe Planin Rajonal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Patos, ashtu si në shumë bashki të tjera, përballlet me sfida të shumta si rritja e vazhdueshme e sasisë së mbetjeve, mungesa e sistemit të ndarjes në burim, pranisë së deponive të pakontrolluara, dhe ndikimi i tyre në mjedis dhe shëndetin publik. Në këtë kontekst, hartimi i një Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane bëhet i domosdoshëm për:

- Organizimin dhe modernizimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve;
- Vendosjen e standardeve për grumbullimin selektiv dhe trajtimin e mbetjeve;
- Përmbushjen e kërkesave ligjore kombëtare dhe angazhimeve ndërkombëtare.
- Zvogëlimin e ndikimit negativ të mbetjeve në mjedis, ujëra, tokë dhe ajër;
- Nxitjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit;
- Promovimin e një ekonomie më të gjelbër dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal.

Ky plan i jep Bashkisë Patos një mjet strategjik dhe operativ për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve dhe për të garantuar mbrojtjen e burimeve natyrore për brezat e ardhshëm.

II. POLITIKAT KOMBËTARE DHE RREGULLIMI LIGJOR E INSTITUCIONAL NË MENAXHIMIN E MBETJEVE.

2.1 Politika kombëtare dhe parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve.

Qeveria Shqiptare miratoi më 27 Maj 2020, me VKM nr. 418, “Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035”. Ky dokument përcakton udhëzime për njësitë e qeverisjes vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke u bazuar në parimet e Bashkimit Evropian.

Dokumenti i Politikave Strategjike udhëzon njësitë e qeverisjes vendore për përcaktimin e objektivave të tyre specifike vendore, të matshëm, realistë, të arritshëm, bazuar në situatën e tyre ekzistuese dhe standardin minimal të miratuar për menaxhimin e mbetjeve.

Strategjia, përmes përcaktimit të rëndësisë së standardit minimal të menaxhimit të mbetjeve në nivelin lokal (*grumbullimi 100% i mbetjeve në zonat urbane, transporti i sigurt dhe depozitimi i mbetjeve venddepozitimet e kontrolluara*), i ndjekur nga standardi ligjor (*mbledhja dhe trajtimi i diferencuar sipas rrymave specifike të mbetjeve, përcaktuar në ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve, ligji nr. 10463 datë 22.09.2011, i ndryshuar*), përcakton trajektoren që duhet të ndjekin njësitë vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve. Nisur nga kjo, NJQV-të udhëzohen të përmbushin, së pari, standardin minimal për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve dhe më pas të planifikojnë hapat për të përmbushur standardin ligjor.

Llogaritja e kostos së menaxhimit të mbetjeve për standardin minimal të shërbimit, gjatë hartimit të planeve lokale për menaxhimin e mbetjeve, është një hap i detyrueshëm (VKM nr.319, datë 31.05.2018) për NJQV-të. Kjo kosto duhet të jetë e përballueshme nga tarifat e pastrimit, të cilat përcaktohen për të mbuluar koston e shërbimit për standardin minimal. Për më tepër, bazuar në konceptin e përballueshmërisë, të përcaktuar në dokumentin e politikave strategjike dhe në ligjin për vetëqeverisjen vendore (2015), NJQV-të duhet të jenë të afta të përcaktojnë hapa cilësor të saktë për të kaluar nga standardi minimal i ofrimit të shërbimeve drejt një përmirësimi financiar të përballueshëm dhe të arritshëm të ofrimit të shërbimit.

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

Parimet kryesore të menaxhimit të mbetjeve:

- **Hierarkia e mbetjeve:** Prioriteti është parandalimi dhe ripërdorimi i mbetjeve, ndërsa depozitimi është opsioni më pak i preferuar.



- **Parimi reduktues:** Minimizimi i gjenerimit të mbetjeve për të ruajtur burimet natyrore.
- **Parimi parandalues:** Reduktimi i impakteve negative nga mbetjet në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.
- **Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:** Menaxhimi i mbetjeve duhet të bëhet sa më afër vendit të prodhimit të tyre.
- **Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit:** Prodhuesit duhet të mbulojnë koston e menaxhimit të mbetjeve që krijojnë.

Qëllimet strategjike për periudhën 2020–2035:

1. Sigurimi i grumbullimit 100% të mbetjeve në zonat urbane.
2. Transporti i sigurt dhe depozitimi i mbetjeve në venddepozitimet e kontrolluara.
3. Mbledhja dhe trajtimi i diferencuar sipas rrymave specifike të mbetjeve.
4. Përmirësimi i kapaciteteve financiare dhe teknike të njësive vendore për menaxhimin e mbetjeve.

Njësitë e qeverisjes vendore janë të udhëzuara të hartojnë plane lokale për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë llogaritjen e kostonë së shërbimit dhe përcaktimin e tarifave të pastrimit që mbulojnë këto kosto.

2.2 ASPEKTET INSTITUCIONALE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

2.2.1 Organizimi në nivel qendror

Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve në Shqipëri është i strukturuar përmes një qasjeje të koordinuar ndërinstitutionale, ku institucionet qendrore hartojnë politika, strategji dhe ligje ndërsa njësitë vendore i zbatojnë ato në terren.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) është institucioni përgjegjës kryesor për:

- Hartimin dhe Përditësimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për mbetjet dhe akteve nënligjore përkatëse.
- Dhënien e lejeve mjedisore për aktivitete që lidhen me trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve me ndikim të lartë.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

- Mbledh dhe raporton të dhëna mbi gjenerimin dhe trajtimin e mbetjeve.
- Harton raporte vjetore mbi gjendjen e mjedisit dhe monitoron zbatimin e indikatorëve për mbetjet.
- Mban Regjistrin Kombëtar të Mbetjeve.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)

- Siguron integrimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve në planet kombëtare dhe rajonale të zhvillimit të territorit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

- Përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve spitalore në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

- Përcakton rregulla për ekonominë qarkulluese, ripërdorimin dhe përpunimin e mbetjeve si burim i mundshëm ekonomik.

Koordinimi mes nivelit qendror dhe atij vendor ndodh përmes platformave ndërinstitutionale ose akteve udhëzuese, të cilat specifikojnë standardet për grumbullimin dhe ndarjen në burim, përfshirjen e sektorit privat dhe shoqërisë civile si dhe mbështetjen financiare për bashkitë përmes programeve kombëtare apo fondit të zhvillimit rajonal.

2.2.2 Organizimi në nivel lokal

Menaxhimi i mbetjeve në nivel lokal është funksion i deleguar nga qeveria qendrore te njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.

Bashkia përcakton:

- Strukturat bashkiake për administrimin dhe monitorimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve si dhe inspektimin e territorit urban

- Përcakton buxhetin e mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve operative dhe të investimeve në fushën e mbetjeve; vendos tarifa për Menaxhimin e mbetjeve urbane në territorin nën juridiksionin e saj dhe autorizon organizmat publikë apo privatë që t'i grumbullojnë ato.
- Harton dhe miraton rregullore lokale specifike territoriale për çdo metodë Menaxhimi për mbetjet duke zbatuar rregulloret “tip” të miratuara nga MTM.
- Harton planet e Menaxhimit të mbetjeve urbane në nivel lokal apo rajonal në bashkëpunim me autoritetet rajonale dhe autoritetet e tjera lokale fqinje.
- Përcakton vendet dhe metodologjitë e përshtatshme për grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin përfundimtar të mbetjeve në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit.
- Mbledh të dhëna dhe mban regjistrin lokal të mbetjeve si dhe kryen fushata sensibilizuese.

Në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe për mbetjet, bashkitë kanë detyrimet si më poshtë:

- Hartimin dhe zbatimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve.
- Të ofrojë shërbime publike që lidhen me pastrimin urban, mbledhjen e mbetjeve, shërbimet komunale dhe mjedisore.
- Të sigurojë infrastrukturën për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve në nivel lokal.
- Të hartojë dhe zbatojë politika mjedisore në përputhje me planet kombëtare.
- Organizimin e sistemit të mbledhjes, transportit dhe depozitimit të mbetjeve.
- Promovimin e ndarjes në burim, riciklimit dhe minimizimit të mbetjeve.
- Monitorimin e pikave të grumbullimit, mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme si dhe marrjen e masave administrative ndaj ndotësve.
- Sigurimin e edukimit dhe ndërgjegjësimin mjedisor për publikun.
- Bashkëpunimin me strukturat qendrore për raportime dhe përditësim të të dhënave.

Në kuadër të procesit të integritetit, bashkitë duhet të:

- Arrijnë objektivat për ndarjen në burim dhe riciklimin e të paktën 55% të mbetjeve komunale deri në vitin 2025.
- Parandalojnë depozitimin e mbetjeve organike pa përpunim paraprak.
- Mbështesin modelet e ekonomisë qarkulluese dhe zgjidhjet lokale për trajtimin e mbetjeve.

Këshilli Bashkiak: është autoriteti përfaqësues lokal me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për miratimin e buxhetit të mbetjeve dhe investimeve, miratimin e strukturave urbane për administrimin e mbetjeve, miratimin e nivelit të tarifave të mbetjeve dhe miratimin e dokumenteve rregullatore dhe strategjike (plane, plan-veprime).

Policia bashkiake është përgjegjëse për të evidentuar dhe parandaluar ndotjen mjedisore dhe depozitimet e papërshtatshme të mbetjeve dhe për të siguruar zbatimin e urdhërave, akteve lokale dhe vendimet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

2.3 Instrumentet e menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor.

Instrumentet e menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor përfaqësojnë mjetet, politikat dhe praktikat që përdoren nga bashkitë për të siguruar një sistem të qëndrueshëm, efikas dhe

mjedisor për menaxhimin e mbetjeve. Menaxhimi i integruar i mbetjeve përfshin të gjitha fazat: parandalimin, reduktimin, riciklimin, ripërdorimin, mbledhjen, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Më poshtë janë instrumentet kryesore të menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel vendor:

1.Instrumentet Planifikuese dhe Strategjike

- Planet vendore të menaxhimit të mbetjeve (në përputhje me Planin Kombëtar të Mbetjeve): përcaktojnë objektivat, masat dhe resurset për menaxhimin e mbetjeve për një periudhë disa vjeçare.
- Strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm: përfshijnë komponentin e mbetjeve si pjesë e zhvillimit të gjelbër.
- Hartat e rrugëve për reduktimin e mbetjeve: plane konkrete për minimizimin e mbetjeve të ngurta urbane.

2.Instrumentet Ligjore dhe Rregullatore

- Aktet vendore (vendime të këshillit bashkiak) për tarifat, ndarjen në burim, ditët e mbledhjes, etj.
- Rregulloret e pastërtisë publike dhe menaxhimit të mbetjeve në bashki.
- Kontratat e menaxhimit të mbetjeve me operatorë privatë apo ndërmarrje publike.

3.Instrumentet Institucionale

- Njësitë e menaxhimit të mbetjeve pranë bashkive: përfshirë stafin teknik, inspektoratin dhe sektorin e gjelbërimit.
- Ndërmarrjet publike të shërbimeve komunale: përgjegjëse për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve.
- Partneritetet ndërbashkiake për menaxhimin e integruar të mbetjeve (p.sh. landfill i përbashkët, stacione transferimi, etj).

4.Instrumentet Ekonomike dhe Financiare

- Tarifat për shërbimin e mbetjeve (të lidhura me sasinë ose llojin e mbetjeve).
- Subvencione apo lehtësime për qytetarët që ndajnë në burim.
- Mbështetje financiare për biznese që promovojnë riciklimin ose ekonominë qarkulluese.
- Përdorimi i grant-eve dhe fondeve të huaja (p.sh. IPA, GIZ, GEF, BE) për infrastrukturën dhe pajisjet.

5.Instrumentet teknologjike dhe operacionale

- Pajisje për ndarjen në burim (koshë me ngjyra, qendra grumbullimi).
- Stacione transferimi, linja përzgjedhëse, kompostim lokal, landfill të kontrolluar.
- Sisteme të menaxhimit dixhital të mbetjeve (gjurmimi i mjeteve, aplikacione për raportim nga qytetarët).

6.Instrumentet edukative dhe të ndërgjegjësimit publik

- Fushata sensibilizuese për ndarjen në burim dhe zvogëlimin e mbetjeve.
- Edukim në shkolla dhe komunitet mbi rëndësinë e riciklimit dhe ripërdorimit.
- Programe bashkëpunimi me OJF-të dhe grupet e interesit lokal.

III. PËRSHKRIMI I SITUATËS SË PËRGJITHSHME

3.1 Të dhënat gjeografike dhe demografike

Pozita Gjeografike

Qyteti i Patosit është një qytet satelit i rajonit dhe qendra e industrisë së naftës. Ai bën pjesë në Rrethin e Fierit dhe ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit, shtrihet përgjatë vargut kodrinor i cili ndan fushën e Myzeqesë nga lugina e lumit Gjanica. Ky varg kodrinor vazhdon në formë harku përgjatë rrugës Patos- Fier. Pika më e lartë e rajonit ndodhet në kodrën e Margëlliçit 320 m mbi nivelin e detit. Përpara qytetit drejt veriut dhe veriperëndimit shtrihet fusha e Myzeqesë ndërsa drejt verilindjes fusha e Roskovecit. Në perëndim kufizohet nga territoret e Njesisë Administrative Portëz, në veri kufizohet me territoret e Njesisë Administrative Zharrës dhe në lindje nga territoret e Njesisë Administrative Ruzhdië. Sipërfaqja sipas relievit ndahet në fushore 730 ha dhe kodrinore 1620 ha.

Qyteti i Patosit bën pjesë në Zonën Mesdhetare kodrinore. Kushtet klimatike ndikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kuotat e relievit dhe afërsia me detin.

Demografia

Bashkia Patos përbëhet nga 3 njësi administrative, 1 qytet dhe 18 fshatra. Territori i bashkisë së Patosit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinëz, e cila përbën një burim natyror të rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin ekonomik. Sektorët që ofrojnë punësim për banorët e zonës janë industria e nxjerrjes së naftës, sektori i ndërtimit, bujqësia, blegtoaria dhe pemëtaria. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 82.5 km² me një densitet prej 510.37 banorë/km² sipas Regjistrit Civil.

Tabela 1. Ndarja territoriale e bashkisë Patos

Qarku Fier (Bashkitë)	Nr. i Bashkive	Bashkia	Njësi Administrative	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Fier Patos Patos Lushnje	6	Patos	Patos	Qyteti Patos, fshatrat Kuqar, Dukas, Rerës, Margëlliç, Rusinjë, Banaj, Grizë Lënginas

Divjakë Mallakastër			Zharrëz	Zharrëz, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë
			Ruzhdie	Ruzhdie, Siqecë, Gjinoqarë Drenie, Kasnicë

Sipas Census-it, bashkia numëron 18,227 banorë ndërkohë që, sipas RGJC-së një popullsi prej 41,956 banorë.

Tabela 2 Të dhënat demografike të Bashkisë Patos

<i>Nj.A</i>	<i>Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre</i>	<i>Census</i>	<i>Sipas Regjistrimit Civil</i>
Patos (urban+rural)	1 qytet dhe 7 fshatra, Qyteti i Patosit dhe fshatrat Kuqar, Dukas, Rusinjë, Margëlliç, Rerës, Banaj, Grizë Lënginas.	12,255	
Ruzhdie (rural)	5 fshatra, Ruzhdie, Gjinoqarë, Drenie, Siqecë, Kasnicë.	1,911	
Zharrëz (rural)	6 fshatra, Zharrëz, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë	4,061	
Total		41,956	18,227

3.2 Organizimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.

Organizimi i shërbimit

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet nga Agjencia e Shërbimeve Publike (ASHP) në varësi të Bashkisë Patos. Referuar të dhënave të ASHP për sasinë e mbetjeve të dorëzuara në pikën përfundimtare të trajtimit të mbetjeve, gjatë vitit 2024 janë grumbulluar dhe transportuar 3848,19 ton mbetje urbane. Norma e gjenerimit të mbetjeve në zonën urbane është përafërsisht 0.7 kg/banorë/ditë ndërsa për zonën rurale nga 0.4 kg/banorë/ditë në 0,7 kg/banorë/ditë. Në zonën urbane, në një pjesë të Njesisë Administrative Ruzhdie si dhe në rrugët kryesore ku infrastruktura është e përshtashme në Njësinë Administrative Zharrëz, grumbullimi i mbetjeve bëhet në kontener 1.1 m³. Largimi i mbetjeve drejt incineratorit bëhet nga ASHP me anë të mjeteve teknologjike.

Në Njësinë Administrative Zharrëz kryhet dhe grumbullimi i mbetjeve “derë më derë”, për largimin e të cilave përdoren mjete vetëshkarkuese.

Me shërbimin e largimit të mbetjeve vlerësohet mbulimi i 80 % të territorit të bashkisë Patos. Në të gjithë territorin e bashkisë mbetjet mbledhen të padiferencuara. Sfidë për këtë 5-vjeçar është diferencimi i mbetjeve dhe zbatimi i projekteve me këtë fokus.

Ish-venddepozitimet e mbetjeve janë rehabilituar dhe janë kthyer në zona të gjelbëruara.

Agjencia e Shërbimeve Publike kryen shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (grumbullim dhe transport) gjatë 7 ditëve të javës në qytet dhe në Njësinë administrative Zharrëz ndërsa në Njësinë administrative Ruzhdie është 2 herë në javë.

Infrastruktura

Në territorin e Bashkisë Patos janë shpërndarë 335 kontenierë metalik 1.1 m³, 40 kosha plastik 1100 litra, 15 kontenierë plastikë 770 litra, 15 kontenier plastikë 660 litra dhe 283 kontenier plastik 120 litra.

Bashkia parashikon që çdo vit ajo të kryejë blerjen e kontenierë të rinj për të zëvendësuar ata kontenierë, të cilët janë të amortizuar apo janë dëmtuar plotësisht.

3.3 Shërbimi i pastrimit të rrugëve dhe shesheve

Shërbimi i fshirjes të shesheve dhe trotuareve kryhet çdo ditë të muajit, shërbimi kryhet manualisht me fshesë, ku pas aktivitetit të fshirjes, hedhurinat grumbullohen dhe transportohen me karrocë dore deri në pikën e grumbullimit më të afërt.

3.4 Gjenerimi i mbetjeve dhe trajtimi final i mbetjeve

Sasia totale e mbetjeve që grumbullohen nga Bashkia Patos dhe dërgohen në Inceneratorin e Fier (13,5 km larg qendrës).

3.5 Aspektet financiare të shërbimit të pastrimit

Llogaritja e kostos për menaxhimin e mbetjeve është bërë në bazë të VKM nr. 319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Sistemi standard i llogaritjes së kostos për menaxhimin e mbetjeve për një NJVV të vetme bazohet në të paktën 6 nga blloqet e të dhënave të mëposhtme:

1. Të dhënat e përgjithshme për njësinë administrative apo zonën e shërbimit (*Tipologjia e NJVV-së, nr. i popullsisë, vizitorët dhe turistët, distancat rrugore, sasia e mbetjeve të gjeneruara*);
2. Investimet kapitale (*Turnet; kamionët për grumbullimin e mbetjeve, kazanët*);
3. Kostot operative (*mirëmbajtje, transport dhe personel, kostoja e karburantit*);
4. Kostoja për trajtim në landfill (*Kostot e trajtimit mund të jenë subjekt i ndryshimit, bazuar në sasinë e mbetjeve që shkon në fushëdepozitim dhe në ndryshimin e shërbimeve që kryhen në të*);
5. Kostot e amortizimit (*riinvestimi ndikon ndjeshëm në koston për mirëmbajtje, investime dhe eficiencë të shërbimit*);
6. Kostot administrative (*uniforma, mjete për grumbullimin, pastruesit kimikë, etj*);
7. Përllogaritja e kostove totale të shërbimit.

Sasia e mbetjeve të gjeneruara u referohet vetëm mbetjeve shtëpiake, duke mos përfshirë rrymat e tjera si mbetjet e rrezikshme, ato bujqësore, inertet dhe mbetjet voluminoze, të cilat duhet të trajtohen veçmas në bazë të kuadrit përkatës ligjor. **Sasia e gjenerimit të mbetjeve për frymë është shifra më e rëndësishme që ndikon në gjithë sistemin. Prandaj është i rëndësishëm të verifikohet gjenerimi i vërtetë duke peshuar mbetjet bazuar në një plan standard.**

3.5.1 Niveli i tarifës për familjet

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Patos nr. 82, datë 27.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025”, tarifa e menaxhimit të mbetjeve (pastrimit) është sipas tabelës më poshtë:

Njësia Administrative	Kategoritë	Niveli i tarifës së pastrimit për familje
Patos	Familje me 1 deri 2 persona sipas gjendjes në certifikatën familjare	2,900 lekë/vit
	Familje me 3 ose më shumë persona sipas gjendjes në certifikatën familjare	4,100 lekë/vit
Zharrëz	Familje me 1 deri 2 persona sipas gjendjes në certifikatën familjare	2,900 lekë/vit
	Familje me 3 ose më shumë persona sipas gjendjes në certifikatën familjare	4,100 lekë/vit
Ruzhdie	Fshati Ruzhdie dhe Gjinoqarë	700 lekë/vit
	Fshati Drenie, Siqecë dhe Kasnicë	0 lekë/vit

Përfitues të lehtësirave fiskale për tarifën e pastrimit janë familjet si më poshtë:

1. Familjet e Veteranëve;
2. Familjet që kanë persona me AK;
3. Familjet e të përndjekurve politikë;
4. Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike;
5. Familjet e përbëra vetëm nga pensionistë sipas certifikatës familjare.

3.5.2 Niveli i tarifës për biznesin

Nr	Kategoritë	Biznesi i vogël				Biznesi i madh	
		Deri në 5,000,000 lekë xhiro		Mbi 5,000,001 deri në 8,000,000 lekë xhiro			
		Bashkia	Nj. Admin	Bashkia	Nj. Admin	Bashkia	Nj. Admin
I	Për çdo njësi tregtimi						
1	Për tregtim bulmet, mish, peshk, fruta, perime, ushqimore.	9,000	6,500	13,000	10,000	30,000	30,000
2	Shitje artikuj industrial (veshje, parfumeri, argjendari e të tjera të ngjashme)	9,000	6,500	13,000	10,000	30,000	30,000
3	Restorante, Bar-bufe, Kafene, Piceri, Fast-food e të tjera të ngjashme me to.	9,000	6,500	15,000	10,500	30,000	30,000
4	Byrektore	9,000	6,500	13,000	10,000	20,000	20,000
5	Njësi tregtimi lëndësh djegëse, karburant, gaz	9,000	6,500	35,000	24,500	50,000	50,000
5.1	Për subjekte Sh.A					200,000	200,000
6	Njësi tregtimi materiale ndërtimi, pllaka, tulla, hidrosanitare, çimento, gëlqere e të tjera të ngjashme me to.	9,000	6,500	15,000	10,500	30,000	30,000
7	Magazina, dyqane që realizojnë shitje me shumicë, supermarketet, tregje private.	9,000	6,500	35,000	24,500	50,000	50,000
II	Për çdo njësi shërbimi						
1	Riparime elektro-shtëpiake, riparime rrobaqepësie, berber, këpucar	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
2	Servic celularësh	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
3	Servis automjeteve, autoshkolla	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
4	Agjenci këmbim valute, agjenci turistike, agjenci transporti, agjenci doganore, kompani sigurimesh, polici private, pastrim kimik, salla lojërash (aerobi, gjimnastikë, palestër), studio fotografike.	9,000	6,500	10,000	7,000	25,000	25,000

5	Salla lojrash për fëmijë, lojra me kompjuter.	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
6	Sallon bukurie, shkollë parukerie, estetist.	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
7	Njësi shërbimi marangoz	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
8	Institucionet jopublike të edukimit (shkolla, kopshte, çerdhe, kurse profesionale të gjuhëve të huaja e të tjera të ngjashme),	9,000	6,500	10,000	7,000	30,000	30,000
9	Shërbime në klinikat e specialiteteve të ndryshme mjekësore, shërbime në laboratorë diagnostikimi.	10,000	7,000	15,000	10,500	30,000	30,000
10	Shitje produkte farmaceutike (farmaci)	10,000	7,000	25,000	17,500	40,000	40,000
11	Hotele/motele dhe çdo njësi akomoduese.	10,000	7,000	30,000	21,000	50,000	50,000
12	Për çdo parking privat dhe lavazh	9,000	6,500	10,000	7,000	20,000	20,000
13	Njësi të tjera që nuk përmenden më lart.	9,000	6,500	10,000	7,000	30,000	30,000
14	Ndërmarrjet (sh.a apo sh.p.k) të shërbimit për energji elektrike e telefonisë, postës, ujësjellësit.	100,000					
15	Institucione shtetërore	80,000					
16	Shërbimi spitalor, diagnostikimi shtetëror apo privat	150,000					
17	Banka, filiale bankash, kompani telekomunikacioni	100,000					
18	Agjenci financiare, filiale agjencish	30,000					
19	Televizione private, radio	20,000					
20	Shoqata jofitimprurëse, fondacione, organizata joqeveritare.	10,000					
21	Ambulantë	5,000					
III	Për çdo njësi prodhimi						
1	Prodhime ushqimore buka, ëmbëlsira, bulmeti, pije, etj.	9,000	6,500	15,000	10,500	25,000	25,000

2	Prodhimkonfeksione, veshje, këpucë, etj.	9,000	6,500	35,000	24,500	100,000	100,000
3	Përpunim metalesh, druri, letre, plastmasi, duralumini, kartoni, etj.	9,000	6,500	15,000	10,500	50,000	50,000
4	Komplekse për rritjen dhe therjen e kafshëve, shpendëve, ferma, etj.	30,000					
5	Prodhim materiale ndërtimi, tulla, tjegulla, çimento, furra gëlqere, etj.	70,000					
IV	Profesione të lira						
1	Avokat, noter, përkthyes, mjek, mjek laborant, stomatolog, farmacist, ekspert kontabilist, mësues, veteriner, inxhinier, arkitekt, projektues, agjent sigurimesh, e të tjera profesione të lira, të cilat ushtrohen në ambiente të ndryshme.	10,000	7,000	20,000	14,000	35,000	35,000
V	Biznesi i madh me aktivitet ndërtimi	500,000					
VI	Biznes me aktivitet nxjerrje hidrokarburesh me seli dhe filialet brenda territorit të bashkisë						
1	Kompania Albpetrol sh.a.	3,000,000					
2	Kompania Bankers Petroleum Albania LTD.	3,000,000					
3	Kompania TerraOil Sëiss	1,500,000					
VII	Subjekte që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të bashkisë si karrierë rëre bituminoze, guri, shfrytëzim argjilash, zhavore e të tjera të ngjashme.	100,000					
VIII	Subjekte që kryejnë shërbime si projekte, studime në fushën e hidrokarbureve.	150,000					

Theksojmë se tarifa e menaxhimit të mbetjeve (pastrimit) përlogaritet dhe ndryshon në çdo rast të ndryshimit të blloqeve të dhënave të mësipërme. Niveli i tarifës do të jetë në nivelin e koston së shërbimit dhe jo më i lartë. Fondi i grumbulluar duhet të shërbejë për përmirësimin e shërbimit dhe për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

DRAFT

IV. INDIKATORËT E PERFORMANCËS

Në përfundim të procesit për evidentimin e gjendjes ekzistuese të shërbimit në Bashkinë Patos, është bërë vlerësimi i performancës bazuar në indikatorët e performancës:

1. Cilësia e shërbimit;
2. Qendrueshmëria mjedisore;
3. Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare;
4. Qendrueshmëria institucionale.

Secili prej indikatorëve kryesorë ka indikatorët e tij specifikë, të cilët u përdorën për llogaritjen e indikatorit kryesor, siç shpjegohet më poshtë:

Cilësia e shërbimit - Ky indikator përbëhet nga tre indikatorë specifikë:

C1.Mbulimi me shërbim i zonës: ky indikator tregon sasinë e mbetjeve të grumbulluara në NJA/bashki nga Agjencia e Shërbimeve Publike kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara në njësi. Për këtë indikator u përdor formula për zonat urbane dhe për zonat rurale të Bashkisë Patos.

Në rastin e Bashkisë Patos për llogaritjen e këtij indikator, janë marrë vlerat e sasisë së mbetjeve që depozitohen në pikën fundore të depozitimit të mbetjeve (incinerator Fier) dhe vlerat e llogaritura në sajë të normës së gjenerimit dhe numrit të popullsisë, për të llogaritur përqindjen e mbulimit të zonës me shërbim.

C2.Pastërtia e bashkisë: ky është një indikator gjithëpërfshirës, i cili vlerësohet nga këto kriterë vlerësimi:

1. Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve (prezenca e mbetjeve të akumuluar rreth PGM);
2. Efektiviteti i pastrimit të rrugëve (prezenca e mbetjeve në rrugë);

Në përcaktimin e këtij indikator, situata është vlerësuar si nga vëzhgimet në terren në të gjitha NJA-ve të bashkisë Patos.

C3: Shkalla e kënaqësisë publike: ky është një indikator cilësor për shërbimin që ofron bashkia, dhe vlerësohet në sajë të pyetësorëve të ndryshëm me komunitetin. Zakonisht ky indikator llogaritet në sajë të një pyetje të vetme: **A jeni të kënaqur me shërbimin e grumbullimit të mbetjeve që ofrohet në njësinë tuaj?**

Qendrueshmëria mjedisore - Ky indikator përbëhet nga dy indikatorë specifikë.

D1: Shkalla e grumbullimit të diferencuar: ky indikator prezanton shkallën e sasisë të mbetjeve që grumbullohen të ndara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara. Në lidhje me llogaritjen e këtij indikator, për NJA-ve të bashkisë nuk është kryer ndonjë llogaritje pasi ka iniciativa të pakta për grumbullimin e ndarë të mbetjeve.

D2: Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave: ky indikator shpreh sasinë e mbetjeve që trajtohen në impiante të autorizuar. Në lidhje me këtë indikator, të gjitha NJA në të cilat ofrohet shërbimi i dërgojnë mbetjet në pikën fundore të depozitimit të mbetjeve Incinerator Fier.

Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare - Ky indikator përbëhet nga 3 indikatorë specifikë:

E1 Mbulimi i Kostos: ky indikator mat sa është kosto e plotë e shërbimit e mbuluar nga grumbullimi i tarifave.

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën e financës dhe të taksave në bashki për të gjitha NJA-ve.

E2 Shkalla e mbledhjes së tarifës: ky indikator reflekton kapacitetin e popullsisë për të paguar tarifën.

Llogaritja e këtij indikator, ashtu siç tregohet edhe në analizën financiare të gjendjes ekzistuese, është kryer në sajë të konsultave me zyrën e taksave në bashki për të gjitha NJA-ve. Ky indikator nuk reflekton plotësisht kapacitetin e popullsisë që është rezidente në bashki, pasi jo të gjitha njësitet paguajnë tarifën.

E3 Transparenca në sistemin e faturimit: ky është një indikator cilësor, i cili ka tre shkallë vlerësimi:

- a. I ulët: nuk ka një sistem faturimi për tarifën e pastrimit
- b. Mesatar: ka një sistem faturimi dhe konsumatori merr një faturë
- c. I lartë: ka një sistem faturimi dhe konsumatori ka informacion dhe kupton tarifën e llogaritur dhe mënyra e llogaritjes është e qartë dhe transparente për të gjithë komunitetin.

Sistemi i faturimit në bashkinë Patos, në ato njësi të cilat e aplikojnë tarifën, shoqërohet me një faturë, e cila kryesisht lëshohet në sportelet e bashkisë, për familjet dhe për bizneset në sistemin e taksave dhe tarifave vendore që ata duhet të paguajnë, mënyra e llogaritjes është e njohur për të gjithë komunitetin.

Qëndrueshmëria Institucionale


F1: Transparenca në aspektete institucionale: është një indikator cilësor, i cili vlerësohet nga këto kritere vlerësimi:

- a. Prania e një strukture organizative në bashki për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve.
- b. Nëse janë të trajnuar punonjësit e bashkisë për aspekte të menaxhimit të mbetjeve.
- c. Pasja e një Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të miratuar.
- d. Pasja e një databaze të rifreskuar për të dhëna për mbetjet.
- e. Pasja e një sistemi monitorimi/supervizimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

Më poshte jepen rezultat e vlerësimit të gjendjes ekzistuese sipas indikatorëve të performancës në

Bashkinë Patos:

INDIKATORI 1: Niveli i mbulimit të zonës me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve




INDIKATORI 2: Shkalla e grumbullimit të ndarë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta. Bashkia Patos **nuk kryen grumbullim** të ndarë të mbetjeve sipas kategorive të veçanta.


INDIKATORI 3: Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave (në impiante sanitare ose vend depozitime të kontrolluara)

Bashkia Patos depoziton **100% të mbetjeve të grumbulluara** në vendin përfundimtar të depozitimit të mbetjeve Incinerator Fier.

INDIKATORI 4: Mbulimi i kostos së shërbimit nga realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit.



INDIKATORI 5: Niveli i grumbullimit të të ardhurave nga tarifa e pastrimit kundrejt planifikimit të të ardhurave nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve.



V. PLANIFIKIMI LOKAL I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE

5.1 Vizioni

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të mbetjeve të Bashkisë Patos u formëzua në sajë të një procesi të vazhdueshëm diskutimi dhe konsultimi midis palëve të interesuara të përfshira drejtpërdrejtë në përgatitjen e planit në sajë të analizimit të gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit sipas indikatorëve të performancës dhe propozimit të objektivave afat shkurtër dhe afat mesëm, bazuar në këtë analizë.

Vizioni i Bashkisë Patos: “Të ndërtojmë një bashki me një mjedis të pastër, shërbime efikase për menaxhimin e mbetjeve dhe një komunitet të përfshirë, ku zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja e natyrës ecin përkrah njëra-tjetrës.”

5.2 Objektivat

Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Bashkia Patos gjatë 5 vjeçarit të zbatimit të planit lokal për menaxhimin e mbetjeve kërkon mbi të gjitha të konsolidojë shërbimin në zonat ku aktualisht e ofron këtë shërbim, duke rritur gradualisht cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe ta shtrijë atë në zonat ku aktualisht nuk e ofron shërbimin, kryesisht në zonat rurale:

1. Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë gjatë periudhës 2025 – 2030.
2. Ngritja dhe forcimi i sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim.
3. Zgjerimi i shërbimit nga 85% në 100% gjatë periudhës 2025– 2030.
4. Rritja e mbulimit të kostos operacionale me 10% çdo vit, gjatë periudhës 2025-2030.
5. Përmirësimi i mbledhjes së tarifës dhe efikasitetit financiar të shërbimit.
6. Reduktimi i ndotjes mjedisore dhe mbrojtja e burimeve natyrore.
7. Zhvillimi i bashkëpunimeve me shkolla, komunitetin dhe bizneset për edukim mjedisor.
8. Përfshirja e inovacionit dhe teknologjisë në menaxhimin e mbetjeve.
9. Të promovojmë një ekonomi qarkore në nivel lokal duke reduktuar mbetjet, rritur riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve si dhe duke krijuar mundësi të reja ekonomike përmes valorizimit të mbetjeve dhe përfshirjes së komunitetit dhe bizneseve në praktika të qëndrueshme.

5.2.1 Rrymat e mbetjeve në bashkinë Patos

Bazuar në karakteristikat urbane dhe rurale të territorit, në Bashkinë Patos gjenerohen këto rryma kryesore të mbetjeve:

1. Mbetje urbane të përziera
 - Të prodhuara nga familjarët, institucionet dhe tregtia.
 - Përbëjnë shumicën e mbetjeve të grumbulluara.
2. Mbetje të riciklueshme
 - Plastikë, letër/karton, kanaçe, qelq.
 - Aktualisht nuk grumbullohen të ndara në burim.
3. Mbetje inerte (ndërtimi dhe prishjeje)
 - Të gjeneruara nga ndërtime individuale, rikonstruksione ose ndërtime publike.
 - Shpesh përfundojnë në zona jo të autorizuara.
4. Mbetje bujqësore dhe organike
 - Kryesisht mbetje bimore dhe kafshësh nga zonat rurale.
 - Kanë potencial për kompostim, por nuk trajtohen aktualisht.

OBJEKTI I PLANIT

Objekti i këtij plani është:

“Të zhvillohet një sistem i integruar, i qëndrueshëm dhe eficient për menaxhimin e të gjitha rrymave të mbetjeve në Bashkinë Patos, duke përmirësuar infrastrukturën, rritur ndërgjegjësimin qytetar, ulur sasinë e mbetjeve që shkojnë për asgjësim dhe promovuar qasjen e ekonomisë qarkore.”

Ky objektiv mbështetet në këto drejtime kryesore:

- Zgjerimi i mbulimit me shërbim në gjithë territorin.
- Ndarja në burim dhe riciklimi i mbetjeve.
- Përfshirja e komunitetit dhe sektorit privat në zgjidhje të qëndrueshme.

5.2.2 Zona e Administrimit të Mbetjeve (ZAM) dhe përfituesit e shërbimit të pastrimit.

Për një organizim më të mirë të shërbimeve dhe eficiencës së sistemit që do të propozohet, zonat e mbetjeve ose zona brenda kufijve administrativë të bashkisë do ndahet në nën-zona mbetjesh që kanë diferenca në lidhje me tipologjinë urbane, infrastrukturën rrugore apo llojin e konsumatorëve. Kjo do të shërbejë për të planifikuar infrastrukturën e nevojshme për skemat e mbledhjes dhe transportit, si dhe shërbime të tjera të ngjashme. Për këtë qëllim, zona e mbetjeve ndahet në këto nënzona:

Nën-zona I

• **Urbane**

- Në këtë nën-zonë do të kategorizojmë zonat me dendësi të lartë popullsie si dhe zonat me tipare të ngjashme me zonat urbane. Referuar metodologjisë së dldp-së, për këtë zonë do të konsiderojmë kryerjen e shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve çdo ditë (7 ditë/javë). PGM do të jenë të shpërndara në mënyrë uniforme kryesisht çdo 50-100m nga njëri-tjetri. Konkretisht në nën-zonën e parë të mbetjeve do të jetë ato NJA ku janë të përqendruara zonat e banuara dhe njësitë tregtare.

Nën-zona II

• **Rurale**

- Në këtë nën-zonë do të kategorizohen zonat rurale dhe me dendësi të ulët popullore. Në këto zona shërbimi do të jetë i rrallë (1 herë në javë ose 2-3 herë në muaj në varësi të sasisë dhe distancave) dhe distanca e PGM do të jetë mbi 200 m, pasi do të jenë pika grumbullimi në distancë të madhe nga njëra tjetra (një për çdo fshat).

5.3 Shërbimet e menaxhimit të mbetjeve

Në këtë plan 5 vjeçar, Bashkia Patos parashikon këto shërbime kryesore të menaxhimit të mbetjeve, të cilat konsistojnë në:

- a. Shërbimi i pastrimit, grumbullimit, transportit të mbetjeve;
- b. Depozitimi i mbetjeve në pikën fundore të depozitimit të mbetjeve Incinerator Fier;
- c. Shërbimi i minimizimit të mbetjeve.

Këto shërbime pasi do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë, do të përfshihen në dy skenarët e propozuar nga bashkia për organizimin e shërbimit në territorin e saj gjatë viteve 2025-2030.

5.3.1 Shërbimi i pastrimit dhe rrugëve

Organizimi i shërbimeve të pastrimit duhet të marrë në konsideratë nevojat për pastrimin e rrugëve dhe shkallën e ndotjes ditore nga mbetjet dhe hedhurinat, apo brenda një periudhe të caktuar ditësh.

Një element shumë i rëndësishëm në organizimin e shërbimeve të pastrimit të rrugëve është edhe kategorizimi i rrugëve në funksion të rëndësisë si më poshtë:

1. **Kategoria e Parë:** (përfshin rrugët kryesore dhe rrugët tregtare) nevojitet shërbimi ditor i fshirjes;
2. **Kategoria e Dytë:** (sistem rrugor periferik në zona me dendësi të ulët urbane, apo në zona me infrastrukturë jo të rregullt dhe rrugë të paasfaltuara) është i nevojshëm një shërbim mujor pastrimi (fshirje ose thjesht mbledhje mbetjesh).

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve në Bashkinë Patos ofrohet nga sektori publik, nga vetë bashkia. Ky shërbim konsiston në aktivitetet më poshtë:

- Grumbullimi i mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenerëve publik si dhe rreth tyre.
- Dezinfektimi i kontenerëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor,
- Transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në depozitimin e tyre përfundimtar në Incinerator Fier.

5.3.2 Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve

Në parashikimin e shërbimeve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, bashkia duhet të marrë në konsideratë parimin për parandalimin e ndotjes. Cilësia dhe kostot e shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve urbane lidhen drejtpërdrejtë me mënyrën se si konsumatorët hedhin mbetjet, përdorin PGM, respektojnë oraret e përcaktuara dhe zbatojnë rregullat lokale për menaxhimin e mbetjeve. Në këtë aspekt, bashkia duhet të plotësojë kuadrin e saj rregullaror në sajë të:

- Hartimit të një rregulloreje vendore për menaxhimin e mbetjeve, ku do të përcaktohen procedurat, protokollet e punës, parashikimet se çfarë do të ndodh në rast avarish apo aksidentesh në punë, të drejtat dhe detyrimet e të gjitha grupeve të interesit të përfshira në menaxhimin e mbetjeve si dhe gjobat përkatëse në rast të shkeljeve të evidentuara
- Rritjen e fushatave të ndërgjegjësimit dhe programeve të edukimit;
- Marrëveshje me konsumatorët e mëdhenj, për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e secilës palë, për dorëzimin e mbetjeve në pikat e caktuara nga bashkia, ose grumbullimi i tyre nga bashkia, në sajë të një kontrate të veçantë, në pikat e gjenerimit të tyre.

5.3.3 Minimizimi i mbetjeve

Objektiv për Minimizimin e Mbetjeve – Bashkia Patos

“Të ulim në mënyrë progresive sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe të depozituara, përmes ndërgjegjësimit qytetar, ndarjes në burim, ripërdorimit dhe rritjes së përfshirjes së bizneseve dhe bujqësisë në praktika të ekonomisë qarkore.”

Masa dhe Veprime të Rekomanduara për Minimizimin e Mbetjeve

1. Fushata të vazhdueshme ndërgjegjëse
 - Edukim në shkolla, komunitet dhe media për uljen e mbetjeve në burim.
2. Vendorsja e kontejnerëve për ndarje në burim (plastikë, letër, qelq)
 - Fillimisht në zona urbane e më pas gradualisht edhe në fshatra.
3. Nxitja e ripërdorimit të sendeve dhe pajisjeve të përdorura
 - Krijimi i një “këndi të ripërdorimit” në bashki (Reuse corner) për mobilje, veshje, pajisje etj.
4. Kompostimi i mbetjeve organike
 - Promovimi i kompostimit familjar dhe ngritja e një njësie kompostimi për përdorim bujqësor.
5. Mbështetje për iniciativat e riparimit dhe qendrave “Repair Café”

► Vend ku qytetarët mund të riparojnë pajisje me ndihmën e profesionistëve vullnetarë.

6. Zbatimi i politikës “Zero Ëaste” në institucionet publike

► Ndalimi i përdorimit të plastikës njëpërdorimshe, dixhitalizim i dokumenteve.


7. Bashkëpunim me operatorë të riciklimit për grumbullim të ndarë dhe shpërblim simbolik për qytetarët

► Shembull: 1 kg kanaçe = zbritje simbolike nga fatura e pastrimit.

VI. SKEMAT E PROPOZUARA PËR GRUMBULLIMIN E MBETJEVE

Skema 1. Skenari i ndarjes së mbetjeve në burim në dy rryma me zona pilote, duke synuar fillimisht shtrirjen në Njësinë Administrative Zharrëz për shkak të infrastrukturës.

Ky skenar i propozuar përfshin skenarin 2 por edhe synon ngritjen dhe vënien në funksionim të sistemit të ndarjes së mbetjeve në burim në zona pilote duke synuar shtrirjen e tyre. Zona e parë pilot propozohet të jetë njësia administrative Zharrëz për faktin se në këtë zonë ka një sistem të ngritur dhe funksional të grumbullimit të mbetjeve “derë më derë”. Fillimisht do të mbahen takime dhe fushatë informuese dhe sensibilizuese me banorët, të ndërtohet një grafik për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme në 1-2 ditë në javë dhe 3-4 ditë në javë të kryhet grumbullimi i mbetjeve të pariciklueshme. Me kalimin e kohës grafiku do jetë i ndryshueshëm sipas nevojave dhe mund të kalohet dhe me grumbullime më të detajuara të rrymave të mbetjeve duke grumbulluar një ditë plastikën, një ditë letrën, një ditë qelqin etj. Por e gjitha kjo do analizohet në vazhdim duke parë praktikisht si do realizohet. Fillimisht grumbullimi i mbetjeve të riciklueshme do të përfshijë të gjitha mbetjet e riciklueshme (plastike, letër, qelq dhe metal), por nevojitet gjithashtu dhe një proces tjetër për ndarjen e këtyre rrymave më vete. Sfidë për realizimin e kësaj skeme është sigurimi i një stacioni transferimi që do të shërbejë për magazinimin dhe seleksionimin e mbetjeve. Me kalimin e kohës do të synohet zgjerimi i zonës pilot duke përfshirë fshatra dhe njësi të tjera si dhe duke studiuar në të njëjtën kohë edhe përfshirjen e qytetit në këtë skemë.



Skema 2. Skenari i ndarjes së mbetjeve në shkolla dhe edukimi mjedisor.

Me qëllim pakësimin e sasisë së mbetjeve familjare që depozitohen në kontenerët e qytetit dhe më pas transportimin e tyre në incinerator, aktivitetet në shkolla shërbejnë si një metodë e mirë për të promovuar ndarjen e mbetjeve të riciklueshme që në burim. Propozohet vendosja e koshave të veçantë për mbetjet e riciklueshme të ndara në kategori (letër, plastikë, qelq dhe metal) në oborret e shkollave. Këto kosha të shërbejnë fillimisht për mbetjet e prodhuara nga fëmijët në ambjentet shkollore duke filluar me sensibilizim dhe më pas duke vazhduar me inkurajimin e fëmijëve për të sjellë në ambjentet shkollore mbetjet e riciklueshme të familjeve të tyre të ndara në qese të veçanta. Bashkia nga ana e saj përveç faktit se do të lehtësojë gjithë procesin duke pajisur shkollat me kosha të ndarë dhe me sensibilizim, do të kujdeset për të lidhur marrëveshje midis shkollave dhe shoqërive private ricikluese të cilat të grumbullojnë këto mbetje direkt nga shkolla. Të ardhurat që do rezultojnë nga shitja e mbetjeve të riciklueshme të shkojnë si të ardhura për shkollat të cilat mund t'i përdorin për aktivitetet e tyre. Kjo mënyrë stimuluese do të ndikojë pozitivisht për përfshirjen e fëmijëve në procesin e grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme. Nga gjithë ky proces, Bashkia Patos përfiton një reduktim të mbetjeve urbane në sasi të konsiderueshme pasi familjet e fëmijëve do hedhin më pak mbetje në kontenerët e qytetit. Ndërkohë koncepti dhe procesi i ndarjes së mbetjeve në familje bëhet efektiv. Kjo skemë është tërësisht e pavarur nga skemat e tjera që do të aplikojë bashkia për grumbullimin e mbetjeve por duke ndikuar pozitivisht në reduktimin e mbetjeve. Me kalimin e kohës numri i shkollave mund të shtohet, duke përfshirë gjithë qytetin.


Për realizimin sa më funksional të kësaj skeme duhet të kihen parasysh disa aspekte të cilat duhen menaxhuar në mënyrë efektive, si:

- Duhet të merren masa për blerjen e koshave për mbetjet e riciklueshme nga ana e Bashkisë. Këto kosha mund të realizohen me kosto të ulët pasi dhe mbetjet që do grumbullojnë nuk janë ushqimore dhe nuk krijojnë problem me aromat e këqija, mbledhjen e insekteve apo me lëngjet që rrjedhin nga mbetjet ushqimore. Koshat të jenë me konstruksion metalik dhe me rrjeta teli për të ulur kosto, për të mbajtur

kapacitete të mëdha duke konsideruar që fëmijët do sjellin mbetje të riciklueshme nga shtëpia dhe për të kontrolluar vizualisht dhe përbërjen e mbetjeve.

- Specialistët e Bashkisë Patos duhet të organizojnë orë mësimore me nxënësit për t'u shpjeguar procesin e riciklimit dhe atë të ndarjes së mbetjeve në shkollë dhe në familje.

- Sfidë mbetet përfshirja në proces e shoqërive private ricikluese. Mendojmë se interesi i tyre ekziston në transportin e sasive të konsiderueshme të mbetjeve të riciklueshme që mblidhen nga fëmijët dhe familjet e tyre.



Skica e aktivitetit: Pas përzgjedhjes së zonës së synuar për aktivitetin e ndarjes së të riciklueshmeve në shkollat të kryhet një studim për grumbulluesit dhe ricikluesit në lagjet e synuara dhe të zhvillohet një aktivitet studimi me nxënësit për të analizuar sasinë dhe përbërjen e mbetjeve të riciklueshme të prodhuara në shkollat e synuara. Më pas duhet të vendoset një frekuencë e përshtatshme grumbullimi (shitje). Pas marrëveshjes përfundimtare për bashkëpunim me grumbulluesit dhe shkollat e synuara duhet të bëhet vendosja në secilën shkollë e thasëve të grumbullimit dhe koshave të riciklimit dhe duhet të vendoset data për fillimin e aktivitetit. Përpara fillimit të aktivitetit të ndarjes së të riciklueshmeve, duhet të kryhet për secilën shkollë shpjegimi i rregullave duke përdorur materiale vizuale me vizatime dhe skema.

Pritshmëritë: Duke e patur aktivitetin e zbatuar në shkollat ekzistuese në të njëjtën lagje, fëmijët nga një familje që shkojnë në shkollat të ndryshme në lagje mund të zbatojnë të njëjtat rregulla dhe nxënësit mund të vazhdojnë të njëjtin aktivitet edhe pas kalimit në një nivel më të lartë të shkollës në lagje. Duke u zbatuar në shkollë, aktiviteti mbart një aspekt edukativ dhe prindërit e nxënësve përpiqen për të vendosur një shembull dhe të fillojnë ndarjen e mbetjeve të riciklueshme në shtëpitë e tyre. Kufizimi i llojeve të riciklueshme të ndara në shkollat mund të nxisë pyetjet si: Pse nuk grumbullojmë letër? Pse nuk grumbullojmë qese plastike dhe qese ambalazhi? Kjo ndihmon në të kuptuarin në lidhje me gjëndjen e tanishme të riciklimit në zonë. Në zonën ku aktiviteti i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në shkollat është duke u zhvilluar ose në zonën ku Bashkia ka në plan të zbatojë një program pilot për ndarjen e mbetjeve në dy rryma, të riciklueshmet në një qese dhe të pariciklueshmet në qesen tjetër. Skica e aktivitetit: Pasi grumbullimi i ndarë në shkollat të jetë bërë një praktikë duhet të kryhet një pyetësor me prindërit e

nxënësve për të kërkuar dakordësinë e tyre për të ndarë dhe grumbulluar materialet e riciklueshme të prodhuara në shtëpitë e tyre në shkollë. Të vendoset një ditë në javë grumbullimi nga secila shkollë në mënyrë që nxënësit të sjellin të riciklueshmet e prodhuara të mbledhura nga shtëpitë e tyre në shkollë në ditën e caktuar. Duhet të kryhet monitorim i kujdesshëm për të kontrolluar frekuencën e grumbullimit nga grumbulluesi dhe sasinë e mbledhur të të riciklueshmeve nga secila shkollë. Pritshmëritë: Duke zbatuar “ndarjen” jo vetëm në shkolla por edhe në shtëpi, “ndarja” bëhet si një rregull i përbashkët.

VII. RREGULLORE BASHKIAKE PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE

7.1 Rregullorja dhe plani i monitorimit

Qëllimi

Duke detajuar të drejtat dhe detyrat e gjithë palëve që marrin pjesë në procesin e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, rregullorja synon të lehtësojë zbatimin e kërkesave të legjislacionit të kësaj fushe dhe të mundësojë një kontroll efektiv të vazhdueshëm në zbatimin e tyre.

Objekti i rregullore

Kjo rregullore përcakton mënyrën e administrimit mjedisor të mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Patos duke saktësuar rregullat, teknikat e metodat e administrimit të tyre në çdo fazë të këtij administrimi, pa përfshirë trajtimin e mbetjeve, për mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbetje dhe mbajtjen e një mjedisi të shëndetshëm për banorët e Bashkisë. Përcaktimi i termave

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

-“mbetje e ngurte”: janë lëndët ose objektet që dalin nga veprimtaria njerzore ose ciklet natyrore të destinuara për braktisje.

- “administrim”: grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe trajtimi i mbetjeve, duke përfshirë edhe kontrollin e këtyre operacioneve, për më tepër edhe kontrollin e fushave të shkarkimit dhe impianteve të trajtimit mbas mbylljes së aktivitetit.

-“prodhuesi i mbetjeve”: është personi fizik dhe juridik, veprimtaria e të cilit krijon, prodhon mbetje.

-“grumbullimi i mbetjeve urbane” quhet procesi i pranimit, seleksionimit dhe rigrupimit të mbetjeve në vende të caktuara.

-“grumbullim i diferencuar”: grumbullimi i përshtatshëm për rigrupimin e mbetjeve urbane në fraksione merceologjike homogjene, duke përfshirë fraksionin organik të lagësht, të destinuar për ripërdorim, për riciklim dhe rikuperim të lëndës së parë.

-“dorëzimi” quhet nxjerrja dhe hedhja e mbetjeve urbane nga prodhuesit e tyre në vendet e mbledhjes së mbetjeve urbane,

-“largimi publik i mbetjeve urbane” quhet procesi i dorëzimit, mbledhjes, transportimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane.

- “administrator i mbetjeve”: Shoqëria/ndërmarrja, e së cilës nëpërmjet kontratave të shërbimit, liçencave (leje), Bashkia i beson dhe/ose lejon administrimin e mbetjeve.

-“mbetje të papranueshme”, janë mbetjet e rrezikshme a të vëllimshme, të cilat administrohen me ligje të veçanta.

-“mbetjet e rrezikshme” janë mbetjet toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përlakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja në shëndetin e njeriut dhe në ekosistemet natyrore. -“vend-depozitimi” i mbetjeve është një sipërfaqe toke e caktuar nga organet e qeverisjes vendore për përpunimet dhe manipulimet që do të realizohen.

- “groposje përfundimtare (asgjesim): përfshin proceset, pas të cilave nuk parashikohet përpunim tjetër i mbetjes dhe që mbyllen me groposjen e hedhurinës.
- “përpunim i mbetjes”: është ndryshimi i vetive ose i përbërjes së mbetjes duke e transformuar atë në produkt përfundimtar ose në lëndë të parë apo ndihmëse për prodhimin e produkteve përfundimtare.
- “rikuperim”: operacionet për të siguruar shfrytëzimin e mbetjeve për përfitimin e produkteve, lëndëve të para ose prodhimin e energjisë.
- “riciklim i mbetjes”: ripërtëritja ose rinovimi i vetive të mbetjes për t'u përdorur me pas si lëndë e parë ose si material ndihmës.
- “stokimi i mbetjeve”: quhet procesi i ruajtjes (depozitimit) të produktit pas përpunimit të mbetjes deri në destinacionin përfundimtar.
- “zonë e kontratës” quhet zona brenda kufijve të vijës së verdhe, ku kontraktuesi do të sigurojë shërbimin e administrimit të mbeturinave ndaj konsumatorëve ekzistues, si dhe atyre që mund të shtohen gjatë kohështirjes së kontratës brenda së njëjtës zonë. Kufijtë e zonës së kontratës përcaktohen nga bashkia.
- “zonë e largës” quhet shërbimi i largës së rrugëve dhe në disa raste të trotuareve.

7.1.1 Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbetjeve

- Të mos dëmtohen dhe të mos ndryshohet destinacioni i kontenierëve;
- Të mos digjen mbetje në kontenierë;
- Të mos hidhen mbetje jashtë kontenierëve;
- Të mos hidhen mbetje në sistemin e kullimit dhe në hapësirë publike;
- Të shmangët dhe të parandalohet hedhja e mbetjevevëllimore apo të rrezikshme;
- Të mos hidhen në kontenierë kafshë të ngordhura apo materiale me erë të keqe;
- Të shmangët parkimi i mjeteve pranë kontenierëve për të lehtësuar shërbimin e mbledhjes së mbetjeve;
- Të paguhet tarifat dhe taksat vendore për pastrimin dhe menaxhimin e mbetjeve.

7.1.2 Të drejtat dhe detyrimet e grumbulluesve të mbetjeve

- Operacionet e shërbimeve të mbetjeve të kryhen vetëm nga kontraktorët e licensuara;
- Të pastrohen dhe dezinfektohen kontenierët dhe vend qëndimet e tyre;
- Përdorimi i automjeteve dhe kontenierëve të përshtatshëm;
- Depozitimi i mbetjeve në vendin e përcaktuar (incineratorin Fier);
- Mbajtja e dokumentacionit për mbetjet;
- Shmangia e dëmeve për shëndetin publik dhe mjedisin urban;
- Çështje të tjera të shëndetit publik, sigurisë dhe emergjencës në punë.

Procesi i administrimit të mbetjeve urbane

Procesi i administrimit të mbetjeve synon që:

- a) Të rezultojnë sa më pak mbetje nga veprimtaritë prodhuese.
- b) Në mbetjet e krijuara, të zënë vendin kryesor mbeturinat e degradueshme, të riciklueshme e të përpunueshme.

- c) Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.
- d) Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbetjeve me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis.
- e) Mbetjet t'i nënshtrohen sa më shumë riciklimit dhe përpunimit.
- f) Të grumbullohen dhe të trajtohen të ndara mbetjet në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbetjet e rrezikshme.
- g) Të mos pengohet përdorimi i mëtejshëm i mbetjeve nga trajtimi i tyre në një fazë të mëparshme;
- h) Të pakësohet sa më shumë lëvizja dhe transporti i mbetjeve dhe asgjësimi i tyre të kryhet në impiantin më të afërt.
- i) Të parandalohet ndotja nga mbetjet dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh.
- j) Të ruhen sidomos burimet natyrore nga ndikimet e mbetjeve.
- k) Të dëmshpërblehet dhe të rehabilitohet nga personat fizikë dhe juridikë ndotja dhe dëmtimi që shkaktohet prej tyre nga keqadministrimi i mbetjeve.
- l) Të kryhet groposje e sigurtë për hedhurinat që rezultojnë pas përpunimit të mbetjeve.
- m) Të mënjanohej çdo dëm a rrezik për shëndetin, mirëqënien dhe sigurinë e jetës së personit.
- n) Të garantohen kërkesat higjieniko-shëndetësore dhe të mënjanohej çdo rrezik për ndotjen e mjediseve urbane.
- o) Të ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peisazhi nga degradimi.

Të gjitha llojet e mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë rregullore, pas dorëzimit të tyre nga krijuesit janë pronë shtetërore. Fazat e procesit të administrimit të mbetjeve urbane:

- Procesi i administrimit të mbetjeve përfshin krijimin, grumbullimin, ruajtjen dhe sistemimin e tyre nga krijuesi, dorëzimin sistematik në kazan, transportimin nga kazanet për në vend-depozitim, ndarjen, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin përfundimtar në vend-depozitim.

Klasifikimi i mbetjeve

Në funksion të kësaj rregulloreje mbetjet ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Mbetje urbane
- Mbetje industriale;
- Mbetje të vëllimshme;
- Mbetje bujqësore;
- Mbetje spitalore;
- Mbetje të ndërtimit;
- Mbetje në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza etj.

Sipas origjinës së prodhimit mbetjet ndahen në:

- Mbetje Urbane dhe Mbetje Speciale dhe sipas karakteristikave të rrezikshmërisë në: Mbetje të rrezikshme dhe Mbetje jo të rrezikshme.
- "Mbetje Urbane": quhen mbetjet e shtëpive, të ndërtesave administrative, sociale dhe publike. Në këtë emërtim përfshihen edhe mbetjet që vijnë si rezultat i veprimtarive tregtare dhe shërbimit, vendeve të pushimit dhe argëtimit, sasitë dhe përbërjet e të cilave nuk pengojnë administrimin e tyre bashkë me mbetjet urbane.
- Mbetje speciale janë: a) "mbetje nga aktivitete industriale", ku përfshihen edhe mbetjet e vëllimshme nga këto aktivitete; b) "mbetjet nga aktivitetet bujqësore"; c) "mbetje spitalore"; d) Mbetjet e krijuara nga "aktivitete ndërtimi" ose prishjesh"; e) Mbetje jo urbane nga "aktivitete artizanale", "tregtare" apo "shërbimi".
- "Mbetje Industriale": quhen mbetjet e ngurta të krijuara si rezultat i prodhimit apo proceseve industriale, dhe që nuk bën pjesë në mbetjet e rrezikshme. Mbetje të tilla mund të përfshijnë mbetjet që gjenerohen nga linjat prodhuese për: energjinë elektrike; hekurin dhe çelikun; plastikën dhe rezinat; letrën; produkte gome; produkte guri, qelqi dhe qeramike; prodhime tekstile; mjete transporti, por nuk janë të kufizuara nga to. Ky term, në këtë rregullore, nuk përfshin mbetjet e industrisë minerare dhe asaj të naftës dhe gazit.
- "Mbetje të vëllimshme" quhen objektet e mëdha, të mirat me konsumim të qëndrueshëm si, elektroshtepiake, pajisje informatike, mobilje, pjesë autoveturash, penobetone, metale dhe mbeturina të tjera të vëllimshme, përmasat e të cilave pengojnë përdorimin e metodave të zakonshme të mbledhjes, transferimit ose hedhjes së tyre.
- "Mbetje Bujqësore": quhen mbetjet e krijuara nga kultivimi i bimëve dhe mbarështimi /mbajtja e kafshëve.
- "Mbetje Spitalore" quhen: "mbetjet patologjike" antropogjene, që dalin nga operacionet e autopsisë; "mbetjet mikrobiologjike", që përfshijnë kulturat e mbjella me agjentë të ndryshëm mikrobiologjikë. Këtu përfshihen edhe kulturat e laboratoreve mjekësore, patologjike, farmaceutike, kërkimore - shkencore, industriale dhe të bizneseve; "mbeturinat e mprehta" që përfshijnë gjilpërat, shiringat, thikat e operacioneve.
- "Hedhurinë" (mbetje të fundme) nga aktivitetet e rekuperimit dhe trajtimit të mbetjeve, baltat e prodhuara nga procesi i pastrimit dhe trajtimeve të tjera për ujin dhe filtrimin e ujërave të turbullta dhe nga shembja e shtretërve të lumenjve.
- "Mbetje të rrezikshme": nga përdorimi shtëpiak, janë: Bojëra për lyerje, bojra shkrimi, ngjitës, tretës, produkte fotokimike, pesticide, mbajtës bosh të etiketuar "T", "C" dhe/ose "F" dhe bombula spray, bateri dhe pila, batëri makinash, ilaçe, shiringa, aksesore për informatikën, vajra minerale, vajra vegjetale, tuba fluorishent dhe çdo lloj mbetjeje me përmbajtje merkuri.

Mbetjet objekt i rregullores

Objekt i kësaj rregulloreje janë Mbetjet Urbane.

Në funksion të kësaj rregulloreje, Mbetjet Urbane i ndajmë në dy kategori:

- Mbetjet Urbane të Riciklueshme - të cilat përfshijnë mbeturina që mund të ripërdoren ose riciklohen (mund të përpunohen duke u vënë në përdorim si lëndë e parë). Në këtë kategori përfshihen:
- Mbetjet metalike;

- Mbetjet e lulishteve, kopshteve;
- Mbetjet plastike;
- Letrat dhe kartonat;
- Shishet e qelqit (qelqurinat) etj.
- Mbetje Urbane të pariciklueshme - si p. sh., mbetje ushqimore dhe kuzhine me përbërje të fermentueshme etj, të cilat përmbledhin të gjitha mbetjet urbane, që nuk përfshihen në kategorinë e Mbetjeve Urbane të Riciklueshme.
- Mbetjet që prodhohen nga ekonomitë familjare, por që nuk përfshihen në Mbetjet Urbane, si për shembull: mbetjet e rrezikshme, mbetjet ndërtimore dhe objektet e vëllimshme, transportohen nga vetë prodhuesit e tyre në fushat përkatëse të depozitimit, që specifikohen nga Bashkia përkatësisht për secilën prej mbetjeve. Bashkia mund të ofrojë pika alternative për grumbullimin e tyre pranë zonave të banimit.

DRAFT

7.1.3 Plani i veprimit

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brenda kontenierëve publik si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenierëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit (incineratori Fier).

Nr.	Objektivat afatshkurtër	Aktivitetet	Indikatorët kyç të performancës	Njësia përgjegjëse	Periudha e zbatimit	Buxheti (Lekë)
1	Shërbimet për grumbullimin e mbetjeve që aktualisht mbulojnë 80% të territorit , deri në vitin 2029 të shtrihet pothuajse në të gjithë territorin e Bashkisë.	1.1 Investim në përmirësimin e sistemit të grumbullimit të mbetjeve në Njësinë Administrative Zharrëz dhe shtimi i shërbimit në Nj. Adm. Ruzhdie.	1. Blerje e kontenierëve të rinj për qytetin dhe Nj. Adm. 2. Mirëmbajtje e mjeteve teknologjike dhe/ose shtimin e një mjeti tjetër.	ASHP Bashkia Patos	2025-2029	
		1.2 Trajnim i vazhdueshëm i stafit të ASHP që merret drejtpërdrejtë me menaxhimin e mbetjeve.	1. Trajnimi i punonjësve që merret drejtpërdrejtë me menaxhimin e mbetjeve. 2. Kryerja e trajnimeve periodike 4 herë në vit.	ASHP	2025-2029	
		1.3 Zbatimi i një fushate ndërgjegjësimi për komunitetin	1. Shpërndarja e broshurave dhe fletëpalosjeve për informimin dhe sensibilizimin e komunitetit. 2. Shpërndarja në rrjetet sociale të bashkisë dhe Faqen zyrtare në Internet.	Spektori i Pyjeve dhe Mjedisit ASHP	2025-2029	
2	Qytetarët mbështesin plotësisht shtrirjen e shërbimit dhe kontribuojnë me të paktën ____% me anë të pagimit të tarifës.	2.1 Fushate informuese e komunitetit mbi shërbimin e pastrimit, tarifën dhe rendesinë e pagimit të saj prej tyre.	1. Dëgjuesë publike mbi transparencën e llogaritjes së takses së pastrimit. 2. Informimi i zonave rurale nepermjet degjesave dhe	Bashkia ne mbështetje nga zyrtat që mbajnë të dhënat, bizneset,	2025-2029	

				shperndarjes se broshurave.	qytetarët, institucione		
		2.2	Mundësia e vendosjes së tarifës së pastrimit në faturën e ujit.	1. Me Vendim të Këshillit Bashkiak.	Bashkia në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Ujësjetllës- Kanalizime Fier	2025 e në vazhdim	
3	Njësia Administrative Zharrëz shndërrohet në një njësi kryesore përsa i përket ndarjes së mbetjeve në burim për shkak të infrastrukturës.	3.1	Zbatimi i një skeme për diferencimin e mbetjeve.	1. Vazhdimi i projektit në të gjitha shkollat për ndarjen e mbetjeve në 3 rryma.	Bashkia ASHP Shkollat		
				2. Vendosija e kontenierëve për ndarjen e mbetjeve në 2 rryma fillimisht në një fshat të Nj.Adm. Zharrëz dhe më pas në të gjithë njësinë.	ASHP	2025 e në vazhdim	
		3.2	Zbatimi i një skeme të plotë të ndarjes së mbetjeve nga gjenerimi deri te trajtimi.	1. Përcaktimi i një vendgrumbullimi për mbetjet e riciklueshme dhe miratimi i tij me VKB dhe nga Ministrinë e linjës. 2. Grumbullimi i mbetjeve në mënyrë të diferencuar. 3. Kontraktimi i Kompanive të Riciklimit për mbetjet duke krijuar një ekonomi qarkulluese. 4. Krijimi i një pike kompostimi për mbetjet e gjelbërta.	Bashkia Këshilli Bashkiak MTM MIE ASHP	2025-2029	
4	Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit mbi kujdesin ndaj	4.1	Aktivitete ndërgjegjëse në	1. Përfshirja e të gjitha shkollave në	Bashkia	2025 e në vazhdimësi	


	mjedisit dhe nxitjes së ndarjes së mbetjeve në burim.		shkolla dhe me institucionet.	zhvillimin e orëve të edukimit mjedisor. 2. Informimi nëpërmjet dëgjësave, shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe vendosja e njoftimeve.	Spektori i Pyjeve dhe Mjedisit ZVAP ASHP Njësitë Administrative		
		4.2	Aktivite ndërgjegjësuere në komunitet.	1. Dëgjesa publike 4 herë në vit. 2. Shpërndarja e fletëpalosjeve 3. Ndërgjegjësim nëpërmjet rrjeteve sociale dhe medias.	Bashkia ASHP Njësitë Administrative	2025 e në vazhdimësi	

7.1.6 PLANI I MONITORIMIT

Zbatimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve dhe veçanërisht Plani i Veprimit do të bëhet nga ASHP dhe do të monitorohet nga Spektori i Pyjeve dhe Mjedisit. Monitorimi do të orientohej drejt objektivave të vendosura në këtë plan dhe do të koordinohet me aktorët përgjegjës dhe mbështetës të listuara si dhe do të bëhet shqyrtimi i rezultateve të çdo aktiviteti për arritjen e objektivave nëpërmjet masave të planifikuara.

ASHP do të dokumentojë të dhënat teknike dhe financiare për çdo aktivitet dhe masë të marr në zbatim të këtij plani. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar performancën e sistemit aktual siç janë efikasiteti dhe rikuperimi i kostove. Rezultatet e vlerësimit do të jenë baza për planifikimin buxhetor afatshkurtër dhe afatmesëm si dhe për rishikimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.

Figura më poshtë paraqet ecurinë e dokumentimit, raportimit dhe monitorimit në lidhje me zbatimin e Planit.



7.1.7 Zbatimi i rregullores

Zbatimit të kësaj rregulloreje i nënshtrohen:

- a) Organet shtetërore dhe organizatat vendore.
- b) Gjithë individët, banorë të qytetit e të zonës, kalimtarë të rastësishëm, turistë e pushues, shtetas të huaj rezident në komunë, punonjës në organe e organizma publike e private.
- c) Gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike, tregtare, shoqërore, arsimore, kulturore, artistike, shëndetësore, turistike.
- d) Personat juridikë e fizikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, të angazhuar me kontratë dhe të liçensuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

DRAFT